



## МОИМ: DHP-ja NUK KA EKZEKUTUAR RIMBURSIM TË TVSH-së EDHE NE KËTË RAST, TATIMPAGUESIT KANË BORXH TATIMOR

Drejtoria e të hyrave publike mohon pretendimet dhe tentativat për përhapjen e spekulimeve të OBRM-PDNjKM-së.

Ftojme Naum Stoilkovskin dhe jemi në dispozicion të tij, përmes Akademisë sonë Tatimore, t'i japim arsimit falas për kushtet dhe proceset themelore tatimore. Në konferencën për shtyp, Stoilkovski bëri deklaratat të pavërteta se është bërë rimbursim i TVSH-së, pa njohuri bazë për kushtet dhe proceset tatimore. Në këtë drejtim theksojmë se këto kompani nuk janë të përfshira në aferën e naftës.

E përsërisim se DHP-ja nuk ka bërë rimbursim për tatimpaguesit për të cilët ka folur zëdhënësi i OBRM-PDNjKM-së, Naum Stoilkovski.

Në lidhje me rastin e sotëm, të cilin e ka diskutuar nga OBRM-PDNjKM, vërejmë se tatimpaguesi ka pasur paradhënie tatimore prej 110.384.303,00 denarë, dhe për shumën e deklaruar, Drejtoria e të hyrave publike nuk ka bërë asnjë rimbursim dhe as nuk është shlyer me borxhe të tjera tatimore. E drejta për të zbritur tatimin e mëparshëm shprehet si pretendim tatimor në deklaratat tatimore. Me kontrollin e tatimpaguesve, i njëjti nuk njihet, për të cilin tatimpaguesi është përgjegjës për TVSH-në dhe TVSH-në e përcaktuar shtesë për shkak të dokumentacionit të padorëzuar për arsyetimin e kërkesave të shprehura paraprake. Për këtë tatimpagues ashtu si edhe ditën e djeshme DHPJ-ja ka njoftuar Drejtorinë e policisë financiare për të ndërmarrë procedurat e mëtejshme.

Edhe në rastin e djeshëm të përmendur nga Stoilkovski, nuk bëhet fjalë për rimbursim të realizuar të TVSH-së. Dhe në këtë rast, tatimpaguesi ka bërë deklaratat tatimore me kërkesë tatimore - paradhënie të mbetura për periudhat e ardhshme, (dhe jo kërkesat për rimbursim siç janë bërë publike). Kërkesa e përgjithshme për paradhënie janë në shumë prej 32.944.089 denarë, për të cilat Drejtoria e të hyrave publike nuk ka bërë rimbursim dhe nuk është bërë kompensim me borxhet e tjera tatimore. E drejta për të zbritur tatimin e mëparshëm shprehet si pretendim tatimor në deklaratat tatimore. Me kontrollin e tatimpaguesve, i njëjti nuk është njohur, për të cilin tatimpaguesi është përgjegjës për TVSH-në dhe TVSH-në e përcaktuar shtesë, për shkak të mosdorëzimit të dokumentacionit për arsyetimin e paradhënieve të shprehura.

Edhe një herë rikujtojmë opinionin se kompanive nuk u është bërë rimbursim, por kompanitë e përmendura nga OBRM-PDNjKM -ja kanë borxh tatimor për të cilin sipas kushteve të konstatuara dhe dëshmimeve të marra nga kontrollet e kryera, së bashku me të gjitha dokumentacionet i janë dorëzuar Drejtorisë së policisë financiare për hetime të mëtejshme, duke vepruar në përputhje me kompetencat e tyre ligjore. Gjithashtu janë kërkuar të dhëna për dokumentet e udhëtimit, të cilat janë të shënuara në historikun e ndryshimeve në Regjistrin Qendror të RMV-së.

Publiku duhet të jetë plotësisht i informuar, qytetarët nuk duhet të mashtrohen. Apelojmë OBRM-PDNjKM-në që të përmbahet nga përhapja e gënjeshtreve dhe spekulimeve.